REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	01.08.2023
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkryetar i Komunës Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – Korrik 2023

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2023, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.07.2023-31.07.2023

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM ka zhvilluar aktivitetet si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuara dhe kerkesave të bartura. Gjatë muajit korrik 2023 janë pranuar gjithsejt 41 kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura kanë qenë gjithsejtë 132 lëndë, që në total rezulton të jenë 173 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 41 kërkesa, 29 të miratuara, 12 të refuzuara, 15 kërkesa janë bartur në sektorë të tjerë sipas kompetencës lëndore. Për shqyrtim barten 117 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer apo ka marr pjesë edhe në:

- Vazhdimin e procesit të hartimit të PZHK-së, faza e III-të "Korniza e zhvillimit hapësinor", ku ka vazhduar zhvillimi i procesit të diskutimit publik deri me daten 07.07.2023. Po ashtu është mbajtur punëtoria e radhës lidhur me skenarët dhe Planin e Veprimit në kuadër të proceseve të hartimit të PZHK-së, përkatësisht finalizimi i Vizionit dhe Skenarit te propozuar - zhvillimi i procesit të definimit të Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike.

- Kishte edhe angazhime të veçanta në kuadër të komisioneve të ndryshme, Komisioni ankesave në proceset e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale shqyrtoi 5 ankesa të pranuara, vlerësime të ofertave, pranime teknike, leje mjedisore komunale etj.
- Ka vazhduar procesi për sistemin e adresave. Ky proces është para përfundimit, përkatësisht pritet të përfundon deri në fund të muajit gusht.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

- Angazhimet intensive në procesin e hartimit të PZHK-së, faza e III-të "Korniza e Zhvillimit Hapësinor", parashtrimi i kërkesës në MMPHI për marrjen e pëlqimit për hapjen e shqyrtimit publik.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuara	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Të pezullura	Të refuzuara	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	9	17	10		8	3	5
2.	Leje ndërtimi	5	10	3		2		10
3.	Leje renovimi, apo vendosje e objekteve te përkohshme		2			2		
3.	Leje rrënimi	1	-	1				
4.	Certifikatë përdorimi		1					1
5.	Emertim rruge	2	-				2	
	Nr. i shtepisë /adresa	-	-					
6.	Informacione urbane	2	2	4				-
8.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi		91	1				90
9.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
10.	Kërkesa të tjera	22	9	10			10	11
	Gjithsejt:	41	132	29		12	15	117

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit korrik vazhdoi diskutimi Publik: Korniza e Zhvillimit hapësinor - Vizioni dhe Skenarët e propozuar hapësinor deri me datën 07.07.2023.

SFIDAT:

- Numri i lartë i kërkesave të bartura dhe njëkohësisht numri i lartë i kërkesave të pranuara brenda muajit. Ky numër i lëndëve edhe mëtutje pamundëson shqyrtimin e kërkesave brenda afateve ligjore.

- Pamundësia e shqyrtimit të kërkesave për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi në mungesë të kapaciteteve.